

V E N D I M
Nr.435, datë 26.6.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE TË HERCEGOVINËS PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHAT E ARSIMIT DHE TË SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe të Hercegovinës për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-HERCEGOVINËS PËR BASHKËPUNIMIN NË
FUSHAT E ARSIMIT DHE TË SHKENCËS

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës (më poshtë të quajtura “Palë”):

me dëshirën për të nxitur bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës;
të bindur se këto fusha kontribuojnë në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy popujve;
duke vepruar në përputhje me dispozitat e Konventës Kulturore Europiane, Aktit Përfundimtar të Konferencës së Helsinkit për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë dhe Kartës së Parisit për një Europë të Re,

kanë vendosur të nënshkruajnë këtë Marrëveshje dhe kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët do të nxisin zhvillimin dhe vendosjen e marrëdhënieve të drejtpërdrejta ndërmjet universiteteve dhe institucioneve kërkimore me synim:

- shkëmbimin e teksteve, të kurrikulave, të pajisjeve audio-vizuale, të informacionit të kërkimit shkencor, botimeve dhe të të gjitha llojeve të dokumentacionit përkatës;
- shkëmbimin e anëtarëve të stafit mësimor të universiteteve dhe instituteve teknologjike të tyre, si dhe të studentëve, shkencëtarëve, studiuesve dhe ekspertëve;
- formulimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta të zhvillimit;
- bashkëpunimin ndërmjet instituteve të kërkimit pedagogjik;
- çdo formë tjetër të bashkëpunimit, për të cilën Palët do të bien dakord.

Neni 2

Palët do të ofrojnë bursa për studime universitare, pasuniversitare dhe kërkimore.

Neni 3

Palët do të identifikojnë fushat për zhvillimin e kërkimeve të përbashkëta shkencore, duke marrë në konsideratë shkëmbimin e studentëve universitarë dhe pasuniversitarë si hap i parë drejt iniciativave të mëtejshme në kuadrin e gjerë të bashkëpunimit në fushën e shkencës dhe të kërkimit.

Neni 4

Palët do të ndihmojnë për të siguruar një pjesëmarrje të gjerë të profesorëve, specialistëve dhe kërkuesve shkencorë në seminarët, simpoziumet ose konferencat ndërkombëtare të organizuara në vendet e tyre respektive, si një mjet që do të kontribuojë për shkëmbimin e rregullt të informacionit ndërmjet Palëve.

Neni 5

Palët do të mbështesin pjesëmarrjen në seminare dhe kurset e trajnimit të gjuhës dhe civilizimit të organizuara nga Pala tjetër.

Neni 6

Palët do të zhvillojnë shkëmbimin e njohurive dhe të eksperiencës në të gjitha nivelet e arsimit. Ato do të bashkëpunojnë në trajnimin e punonjësve që punojnë në fushën e administratës së arsimit dhe institucioneve shkencore.

Neni 7

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet organizatave të rinisë shkollore dhe organizatave joqeveritare (OJQ) në fushën e arsimit ndërmjet dy vendeve. Palët do të shkëmbejnë informacion dhe eksperiencë për çështjet e rinisë dhe të OJQ-ve përkatëse, duke synuar zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkollore dhe jashtëshkollore, binjakëzimin e shkollave dhe krijimin e një atmosfere miqësore dhe promovimin e paqes.

Neni 8

Palët do të bashkëpunojnë për prezantimin, në secilin vend, të historisë, të gjeografisë, të kulturës dhe ekonomisë së vendit tjetër, veçanërisht në tekstet shkollore. Për këtë qëllim, ato do të ndërmarrin veprime të përbashkëta, si shkëmbimin e materialeve dokumentare dhe ndërmarrjen e një veprimi të përbashkët për tekstet shkollore.

Neni 9

Palët bien dakord për njohjen reciproke të diplomave, të gradave dhe të titujve shkencorë të Palës tjetër, në përputhje me standardet e konventave europiane. Kushtet përkatëse për këtë njohje reciproke do të përfshihen në marrëveshjen e veçantë që do të nënshkruhet ndërmjet Palëve për ekuivalentimin e diplomave, gradave dhe titujve shkencorë.

Neni 10

Me pëlqimin e Palëve, mund të realizohen dhe aktivitete të tjera që janë në përputhje me objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Palët do të krijojnë një komision të përbashkët (të përbërë nga dy ose tre përfaqësues), i cili do të mbledhet në mënyrë alternative çdo vit në Tiranë dhe Sarajevë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Komiteti do të shqyrtojë çështje që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ai do të përpilojë detajet e programeve të bashkëpunimit, si dhe kushtet e tyre financiare.

Neni 12

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi përkohësisht nga data e nënshkrimit të saj dhe përfundimisht nga data që Palët njoftojnë njëra-tjetrën, për plotësimin e të gjitha kërkesave të nevojshme ligjore të brendshme.

Neni 13

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe, pas kësaj, do të shtyhet në mënyrë automatike për një periudhë tjetër 5-vjeçare, në qoftë se asnjëra nga Palët nuk e denoncon atë me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike 6 (gjashtë) muaj para afatit të skadimit të çdo periudhe 5 (pesë) vjeçare.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua në Sarajevë, më 15 prill 2003 në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.